



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 194 Prot.

Tiranë, më 16/11/2021

VENDIM

Nr. 45, Datë 16.11.2021

PËR

MIRATIMIN E FORMATIT TË FLETËS SË VOTIMIT NË ZGJEDHJET PËR
KOMISIONET E PËRHERSHME NË NJËSITË KRYESORE TË UNIVERSITETIT TË
MJEKËSISË, TIRANË

Në bazë Rregullores së Zgjedhjeve miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr.13, datë 12.02.2020 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", Vendimin nr. 78, datë 13.10.2021, në Urdhrin nr. 120, datë 26.10.2021, të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, "Për fillimin e procesit zgjedhor dhe caktimin e datës së zhvillimit të zgjedhjeve për Komisionin e Përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor" në nivel njësie kryesore, në të 3 (tri) njësitë në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", vendimeve 23 KZ-FM, 12 KZ-FMD, 20 KZ-FSHMT dhe listave të personelit akademik të miratuara nga njësitë kryesore të UMT, Komisioni Institucional Zgjedhor, në mbledhjen e datës 16.11.2021,

VENDOSI:

1. Miratimin e formatit të fletës së votimit të kandidatëve për anëtarë në Komisionin e përhershëm për dhënien e gradës shkencore "Doktor", pranë Fakultetit të Mjekësisë, UMT sipas modelit 1, bashkëlidhur këtij vendimi.